

## VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 24.10.2017, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**PADITËS:** **Blerina Krantja,**  
përfaqësuar nga avokati Bledar Fejzo.

**E PADITUR:** **Banka e Shqipërisë**

**OBJEKTI:** Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pa justifikuar.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin me pagën e 3 muajve për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin me pagën e 1 muajve për shkak të mosrespektimit të afatit të dorëzimit të detyrës.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin me pagën e 1 muajve në përpjesëtim me kohën e punës së kryer gjatë viti kalendarik 2013, për shpërblimin e festave të fundvitit.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin për pushimet vjetore të pakonsumuara.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin të barazvlefshëm me kthimin e tatimit 10% të mbajtur mbi pagat e dhëna si dëmshpërblim nga pala e paditur.

Detyrimi e palës së paditurit për të dëmshpërblyer paditësin për dëmin jo pasuror të shkaktuar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 12, 32/1/2, neni 114/2, 143, 144, 145, 146/1/3, 152/2, 153, 155/3 të K.Punës, Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 21 datë 16.05.2007 i ndryshuar për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë”, neni 625/a/b i K.Civil (praktika e unifikuar të Gjykatës së Lartë të aplikueshme për rastin në gjykim).

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë,** me vendimin nr. 369, datë 03.02.2014 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë së paditëses Blerina Krantja.  
Detyrimin e të paditurit Banka e Shqipërisë t'i paguajë paditëses 2 paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.  
Detyrimin e të paditurit Banka e Shqipërisë t'i paguajë paditëses 8 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.  
Rrëzimin e padisë sa i takon kërtimeve të tjera të padisë si të pabazuara në ligj dhe në prova.

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 1255, datë 08.04.2014 ka vendosur:  
Lënien në fuqi të vendimit nr. 369, datë 03.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit**, ka ushtruar rekurs pala e paditur Banka e Shqipërisë...

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të shkronjës "a" të nenit 63 të ligjit nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*",

#### **V E N D O S I:**

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1255 datë 08.04.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 24.10.2017

**Nr. 31003-03061-00-2014 Regj. Themeltar  
Nr. 00 - 2017 - 2039 i Vendimit ( 818 )**